



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Priljeno/Prodato Received/Delivered	24. 12 / 1	viti god year	
Organ /Hjesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	6347/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.916/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën e datës 09.11.2021 me numër A.nr.916/2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë: Ploja e Rugovës, Dardania II, në Komunë të Pejës, kundër Vendimit me Nr.05/2021 të datës 15.10.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës dhe Sportit, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.916/2021 e datës 11.10.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.05/2021 i datës 15.10.2021 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës dhe Sportit.
- III. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës Rinisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi dhe ankueses ti bëhet kompensimin e 20 % të pagës së ndaluar për tre muaj.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja sipas shkresave të lëndës e punësuar në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, në pozitë “Drejtoresh në Qendrën Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Pejë”, në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore. Kundër ankueses është zhvilluar procedurë disiplinore sipas ankesës nr.3098/2021 të datës 08.09.2021, e parashtruar nga qytetari i Gurakocit në Komunë të Istogut, lidhur me sjelljen e nëpunësve të Qendrës Rajonale për Trashëgimin Kulturore të Pejës-QRTK-së, që

sipas ankuesit punëtorët gjatë kryerjes së detyrave të punës, gjegjësisht matjes së objektit të burgut të Gurakocit në Istog, kanë bërë sjellje të pa hijshme.

Me datë 10.09.2021, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm më shkresë përmes imellit i është drejtuar Kryesuesit të Komisionit të ankesave që të trajtohet ankesa e datës 08.09.2021 ndaj punëtorëve të QRTK në Pejë.

Me datë 15.10.2021 Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, ka nxjerrë Vendimin me nr. Protokolli 38081/2021 KD.NR.05/2021, me të cilin ankueses i është shqiptuar masa disiplinore **“ndales 20% të pagës për një periudhë 3 mujore”**, kundër të cilit vendim ankuesja me datë 09.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se vendimi është nxjerrë jashtë afatit ligjor dhe është në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.11.2021 ka parashtruar kërkesë tek Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për përgjigje në ankesën e ankueses, e cila me datë 19.11.2021 ka dërguar përgjigjen në ankesë me nr. Protokolli 5539/2021 me prova e bashkangjitur gjithsejtë 68 faqe.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:5367/2021 të datës 09.11.2021e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Protokolli 38081/2021 KD.NR.05/2021 i datës 15.10.2021 i Komisionit Disiplinor; Vendimi nr.protokolli 3705/2021 i datës 08.10.2021; Shqyrtim propozimit për ndryshim-Plotësim i listës së Trashigimis Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2021-2022 me nr.protokolli 3691/2021 i datës 08.10.2021; E-mail, i datës 24.08.2021 Lidhur me Burgut Gurakoc Istog; E-mail, i datës 08.07.2021 Lidhur me Burgut në Gurakoc Istog; E-mail, i datës 23.08.2021 Lidhur me Burgut në Gurakoc Istog; E-mail, i datës 04.10.2021 Ftesë për takim-komisioni disiplinor; E-mail, i datës 23.09.2021 Lista për hyrje në mbrojtje të përkohshme; Raport i datës 15.09.2021 për matjet e dimensioneve të ndërtesës së Burgut të Gurakocit të bashkangjitura dhe fotografit e objektit; E-mail, i datës 09.10.2021 Kërkesë nga Burgu i Gurakocit; E-mail, i datës 05.10.2021 Lidhur me Burgut në Gurakoc Istog; E-mail, i datës 05.07.2021 Raporti i Burgut të Gurakoc-Istog; Raporti i datës 02.07.2021 të bashkangjitura fotografit e objektit; E-mail, i datës 23.06.2021 Kërkesë; Kërkesë e datës 21.01.2021; E-mail, i datës 10.10.2020 Regjistri 2020-2021; E-mail i datës 05.10.2020,Lista e trashigimisë kulturore; E-mail, i datës 14.09.2017 Mbrojtje e përkohshme dhe e përhershme; E-mail, i datës 05.10.2017-Informat,Lista e plotësim ndryshimit; E-mail, i datës 29.10.2017, informatë-Kërkesë; Vendimi Nr.protokolli 2937/2021 i datës 26.08.2021; E-mail, i datës 06.09.2021Mbrojtje e përhershme dhe e përkohshme/Planet e mëngjesit; Përgjigje në ankesë e datës 19.11.2021 nr. Protokolli 5539/2021; E-mail, i datës 19.11.2021 Autorizim; Vendim nr.protokolli 2949/2021i datës 27.08.2021 formimi i Komisionit Disiplinor; Ankesa nr.protokolli 3098/2021 e datës 08.09.2021; Procesverbali i datës 05.10.2021; Kopje e planit i datës 25.06.2021; Certifikat e datës 25.06.2021; E-mail i datës 23.06.2021, Kërkesë sipas E-mail i datës 06.10.2021; E-mail, i datës 15.10.2021Kërkesë për dokumentet e Gurakocit; E-mail, i datës 12.10.2021 dhe datës 13.10.2021; Akte emërimi i datës 19.06.2015 me përshkrim të detyrave të punës të datës 31.01.2014;Programi i QRTK-Pejë për vitin 2020; Prova shtesë e datës 21.12.2021, E-maili i datës 10.09.2021; E-maili i datës 22.12.2021; E-maili i datës 21.12.2021; Akt emërimi nr.2540/12 i datës 31.12.2012; Akt emërimi i datës 11.03.2014; Akt emërim i datës 23.02.2021.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar provat e lëndës secilën veç e veç dhe pretendimet e ankueses dhe pas analizimit të provave të tërësishme ka konstatuar se inicimi i procedurës disiplinore është bërë drejtpërdrejt nga Zyrtari Kryesor Administrativ gjegjësisht nga ana e Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së, lidhur me inicimin procedurës disiplinore kolegji konstaton se ZKA ka të drejtë për fillimin e procedurës, **POR** meqenëse ankesa është bërë nga një qytetarë i Republikës së Kosovës, ZKA ka qenë i obliguar që fillimisht kërkesën ta dërgoj tek mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i ankueses me qëllim që mbikëqyrësi ta shtjelloj se për ç ‘far shkelje bëhet fjalë, ta kualifikoj a bëhet fjale për shkelje të lehtë apo për shkelje të rëndë disiplinore, më këtë rastë ZKA i MKRS-së ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 46 paragrafi 2, 2.1 dhe 2.2 ku përcaktohet se “Shkeljet disiplinore ndahen në Shkelje të rënda dhe shkelje të lehta si dhe në kundërshtim me Rregulloren Nr. 11/2020 për Disiplinë dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë gjegjësisht nenin 7 paragrafi 1 dhe paragrafi i cili përcakton se: **‘Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, nëpërmjet ankesave nga qytetarët apo institucione jashtë strukturave të institucionit, e vlerëson paraprakisht atë’**”, paragrafi 4 **‘Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit’**”, Prandaj nga se u tha më lartë ZKA i MKRS ka shkelur këto dispozita ligjore në fuqi dhe aktin nën ligjor, andaj Kolegji konstaton se një inicim i tillë i procedurës disiplinore është i pa ligjshëm dhe njëherit vendim i Komisionit të Ankesave nga fillimi i inicimit të procedurës disiplinore është përfshirë në shkelje.

Bazuar në shkresat e lëndës pretendimi ankimor i ankueses lidhur me mos njoftimin paraprak për fillimin e procedurës disiplinore, është i bazuara sepse në bazë të provave të lëndës është vërtetuar se ankuesja deri me datë 05.10.2021 sipas E-mailit ftesës elektronike për seancë dëgjimore, nuk ka qenë në dijeni për fillimin e procedurës disiplinore, dhe nuk ka pranuar njoftim zyrtar për këtë çështje para seancës dëgjimore nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë, andaj mbi këtë bazë Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit, për mos njoftimin e ankueses për fillimin e procedurës disiplinore, ka vepruar në kundërshtim me nenit 48 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se:” **Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe.....’**”.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: **‘Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës’**, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: **‘Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit’**”.

Meqenëse fillimi i procedurës disiplinore është bërë në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara ligjore Kolegji nuk është lëshuar në trajtimin e shkeljeve materiale.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën

paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.916/2021,

Zyle Miftaku GOJNOVCI
Procesmbajtës

Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinis dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;